



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 10, datë 12.12.2017


PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZGJERIMI I RRJETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT “VODAFONE ALBANIA”
NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 7 STACIONE BAZË”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zgjerimi i rrjetit të komunikimeve elektronike të operatorit “Vodafone Albania” nëpërmjet shtimit të antenave për 7 stacione bazë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Vodafone Albania” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit i jepen subjektit zhvillues veçmas për secilin prej 7 stacioneve bazë, vetëm pas plotësimit të kushteve të poshtëshënuara:
 - a. Për stacionin “**Stadiumi 1248**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
 - b. Për stacionin “**Senatoriumi 1265**”:
 - regjistrimit të Lejes së Legalizimit pranë ZVRPP;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
 - c. Për stacionin “**Praktiker 1263**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
 - d. Për stacionin “**Vasil Shanto 1271**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.



- e. Për stacionin “**Durrës Këneta 1255**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
 - f. Për stacionin “**Fushë-Kuqe 1268**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kurbin.
 - g. Për stacionin “**Vlora SW 1264**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

